



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 1422/2 Prot.

Tiranë, më 03 .08 .2026

V E N D I M

Nr. 210, Datë 03 .08 .2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 177, datë 22.07.2026 e paraqitur nga znj. A.M kundër Bashkisë Fushë Arrëz dhe Bashkisë Skrapar, në të cilën pretendohet diskriminim mbi kategori të caktuara të qytetarëve për shkak të *“moshës”*, *“aftësisë së kufizuar”*, *“vendbanimit”*, *“gjendjes ekonomike”* dhe *“çdo shkak tjetër”*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Ankuesja ka parashtruar se, gjatë ushtrimit të së drejtës për informim sipas ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, Bashkia Fushë-Arrëz ka kërkuar paraqitjen e një dokumenti identifikimi për verifikimin e identitetit të kërkuarit, ndërsa Bashkia Skrapar, përveç trajtimit të pjesës së kërkesës që lidhet me të dhënat e personelit, ka komunikuar një tarifë për përpunimin, anonimizimin dhe riprodhimin e dokumentacionit të kërkuar.

Nga korrespondenca e administruar rezulton se ankuesja ka kundërshtuar kërkesën për dokument identifikimi dhe ka argumentuar se neni 11 i ligjit nr. 119/2014 kërkon emrin, mbiemrin, nënshkrimin dhe të dhënat e kontaktit, por nuk parashikon shprehimisht bashkëlidhjen e kopjes së dokumentit të identitetit. Ajo ka kundërshtuar gjithashtu përdorimin e detyrueshëm të një formulari standard dhe tarifën e komunikuar nga Bashkia Skrapar, duke e konsideruar atë joproporcionale për informacionin e kërkuar në format elektronik.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Në ankesën drejtuar Komisionerit, znj. M nuk e ka kufizuar pretendimin të cenimi i një të drejte të saj për shkak të një karakteristike personale të mbrojtur. Ajo ka kërkuar shqyrtimin e një praktike me interes të përgjithshëm, duke pretenduar se kjo praktikë mund të ndikojë në mënyrë disproporcionale te personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, banorët e zonave rurale ose me akses të kufizuar në internet, personat me aftësi të kufizuara digjitale dhe qytetarët me të ardhura të ulëta.

Nga dokumentacioni rezulton, se në procedurën e zhvilluar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ankueses i është kërkuar plotësimi i dokumentacionit me kopje të dokumentit të identifikimit. Ankuesja e ka kundërshtuar këtë kërkesë dhe ka kërkuar vijimin e shqyrtimit vetëm mbi bazën e emrit dhe adresës elektronike të deklaruar prej saj.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, fillimin e një procedure hetimore; vlerësimin e efekteve të mundshme të diskriminimit të tërthortë; konstatimin e cenimit të aksesit të barabartë në shërbimet publike; dhe rekomandimin e masave për unifikimin e praktikës administrative.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Çështja që duhet zgjidhur në këtë fazë nuk është ligjshmëria materiale e tarifës së Bashkisë Skrapar, interpretimi i ligjit nr. 119/2014 apo ligjshmëria e kërkesës për identifikim në procedurat e së drejtës së informimit. Këto janë çështje që, sipas ligjit të posaçëm, i nënshtrohen mekanizmave të ankimit pranë autoritetit kompetent për të drejtën e informimit dhe, sipas rastit, kontrollit gjyqësor. Në shqyrtimin paraprak të kësaj ankese, Komisioneri verifikon nëse subjekti ankues plotëson kushtet formale dhe materiale për të vënë në lëvizje procedurën sipas ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar, përfshirë identifikimin e palës, legjitimitetin aktiv dhe lidhjen e pretendimit me një viktимë konkrete ose me një subjekt që ligji e autorizon të veprojë për interesa kolektive.

1. Mbi identifikimin e ankueses dhe verifikimin e cilësisë së palës

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 4, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Ky ligj zbatohet për sektorin publik dhe privat duke përfshirë edhe institucionet publike, si dhe të gjithë personat, përfshirë, por pa u kushtësuar në a) të gjithë shtetasit shqiptarë, të huaj apo personat pa shtetësi, si dhe personat fizikë e juridikë vendas dhe të huaj që kanë vendbanim, vendqëndrim apo seli në territorin e Republikës së Shqipërisë. b).....”*.

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”*.

Neni 33, pika 3, e ligjit nr. 10221/2010 parashikon se: *“Ankesa përmban, të paktën: a) emrin e ankuesit; b) shpjegimin se si mund të kontaktohet ankuesi; c) subjektin që pretendohet të ketë kryer diskriminimin, ose shpjegim për pamundësinë e identifikimit të tij; ç) shpjegimin e diskriminimit të pretenduar; d) masat që kërkohen nga komisioneri; dh) datën dhe firmën e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij”*.

Kërkesa ligjore për emrin, datën dhe firmën nuk është një formalitet pa funksion juridik. Ajo shërben për të individualizuar personin që vë në lëvizje organin, për të verifikuar zotësinë dhe legjitimitimin e tij, për të përcaktuar se kujt i atribuohen deklaratimet dhe provat e paraqitura, si dhe për të garantuar vlefshmërinë e njoftimeve dhe përgjegjësinë procedurale të palës. Deklarimi i një emri dhe përdorimi i një adrese elektronike, kur identiteti kundërshtohet ose nuk mund të verifikohet në mënyrë të arsyeshme, nuk e përjashton organin nga detyrimi për të saktësuar identitetin e subjektit që kërkon të fitojë cilësinë e palës.

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë pa interes të drejtpërdrejtë, të drejtat apo interesat e ligjshëm të së cilës mund të cenohen nga rezultati i procedurës”*.

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi”*.

Bazuar në nenin 33, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative. 2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave*

të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”.

Neni 44, pika 2, i Kodit urdhëron organin publik të shqyrtojë paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër i parashikuar nga ligji. Kur konstatohen të meta, organi njofton palën për plotësimin e tyre dhe cakton një afat të arsyeshëm; mosplotësimi i të metave brenda afatit përbën shkak për mospranimin e kërkesës.

Në të njëjtën linjë, neni 65 i Kodit parashikon se, në fillim të procedurës administrative, organi publik verifikon, ndër të tjera, *“legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.*

Këto dispozita, të lexuara së bashku, i japin Komisionerit jo vetëm të drejtën, por detyrimin për të verifikuar identitetin e personit që paraqet ankesën, sa herë që kjo është e nevojshme për të konfirmuar se kërkesa vjen nga subjekti i deklaruar, se firma ose deklarimi i atribuohet atij subjekti dhe se ky subjekt ka zotësi e legjitimim për të vepruar. Kërkimi i një mjeti të përshtatshëm verifikimi nuk barazohet me publikimin apo përdorimin e pakufizuar të të dhënave personale. Dokumenti i identifikimit administrohet vetëm për qëllimin procedural të verifikimit dhe duhet të trajtohet sipas parimeve të ligjshmërisë, minimizimit, konfidencialitetit dhe sigurisë së të dhënave.

Në rastin konkret, ankueses me email-in datë 20.07.2026 nga ana e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i është kërkuar plotësimi i të metës së konstatuar për identifikimin e saj. Ankuesja me email-in datë 21.07.2026 nuk e ka plotësuar kërkesën, por ka kundërshtuar në parim kompetencën e organit për të verifikuar identitetin.

Komisioneri vlerëson se kjo kundërshti nuk mund të prevalojë ndaj detyrimit të organit për të përcaktuar saktë palën e procedurës dhe për të verifikuar kushtet e pranueshmërisë. E drejta për t’iu drejtuar një organi publik nuk nënkupton të drejtën për të zhvilluar një procedurë vendimmarrëse pa qenë i verifikueshëm subjekti që e ka vënë atë në lëvizje. Në këto kushte, duke qenë se ankuesja nuk plotësoi të metën e konstatuar brenda afatit të caktuar, ankesa nuk plotëson kushtet procedurale për t’u marrë në shqyrtim.

2. Mbi mungesën e legjitimitit aktiv për të vepruar në emër të kategorive të ndryshme të popullsisë

Pavarësisht sa më sipër, dhe vetëm për efekt të një analize të plotë të pretendimeve të paraqitura, Komisioneri vlerëson se edhe nëse do të konsiderohej i përmbushur kushti i identifikimit të ankueses, ankesa nuk plotëson një kusht tjetër thelbësor: legjitimitimin aktiv për të kërkuar mbrojtje në emër të palëve të treta. Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, bën dallim të qartë ndërmjet: personit ose grupit të personave që pretendojnë se janë vetë diskriminuar; organizatës me interesa legjitime që vepron në emër të viktimave ose për interesa kolektive; dhe kompetencës së Komisionerit për të filluar hetim administrativ pas marrjes së informacionit të besueshëm.

Neni 32, pika 1, pika “a”, i ligjit nr. 10221/2010, të ndryshuar, parashikon se Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar. Pika “b” parashikon shqyrtimin e ankesave nga organizatat që kanë interes të

ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve që pretendojnë diskriminim, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive. Pika “c” i njeh Komisionerit kompetencën të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të ligjit.

Neni 33, pika 1, parashikon: *“Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit...”*. Pika 2 përcakton se organizatat me interesa legjitime mund të kërkojnë hetime administrative dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal për përfaqësimin.

Sipas nenit 3, pika 11, të ligjit, *“Organizatat me interesa legjitime”* janë organizatat e regjistruara në Republikën e Shqipërisë që kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit. Neni 3, pika 18, përcakton se *“Viktimë”* është çdo person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar sipas ligjit, bazuar në një shkak të mbrojtur.

Znj. A.M ka paraqitur ankesën si person fizik. Ajo nuk ka pretenduar dhe as nuk ka provuar se është organizatë me interesa legjitime, nuk ka paraqitur mandat apo pëlqim të shkruar nga ndonjë person i moshuar, person me aftësi të kufizuara, banor i zonave rurale, person me të ardhura të ulëta apo grup tjetër të identifikueshëm dhe nuk ka provuar se është zgjedhur përfaqësuese e përbashkët e ndonjë grupi.

Kodi i Procedurave Administrative e përforcon këtë përfundim. Neni 35 lejon palën të veprojë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit; neni 37 lejon dy ose më shumë palë të zgjedhin një përfaqësues të përbashkët; ndërsa neni 38 kërkon që zgjedhja e përfaqësuesit të bëhet në formë të shkruar, të deklarohet para organit ose të dokumentohet në një formë tjetër të përshtatshme. Në ankesën e paraqitur nuk ka asnjë akt përfaqësimi dhe asnjë deklaratë të personave konkretë që pretendohet se janë prekur nga praktikat e kundërshtuara.

Pretendimi se një praktikë mund të prekë potencialisht kategori të gjera të popullsisë nuk i jep automatikisht çdo personi cilësinë e përfaqësuesit të atyre kategorive. Interesi publik nuk është i njëjtë me legjitimitimin procedural individual. Mbajtësit e interesave publikë ose kolektivë marrin cilësinë e palës vetëm kur autorizohen nga ligji; ndërsa Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ia njeh në mënyrë të posaçme veprimin për interesa kolektive organizatave me interesa legjitime dhe vetë Komisionerit, në kuadër të kompetencës së tij për hetim kryesisht.

Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b” të LMD-së, ku përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.....”*, ankesa objekt shqyrtimi nuk duhet të pranohet si e papajtueshme me dispozitat e ligjit.

Në rastin në shqyrtim, mangësitë nuk lidhen me vërtetësinë ose jo të pretendimeve mbi tarifën, formularin apo dokumentin e identifikimit; ato lidhen me vetë kushtet që i japin Komisionerit mundësinë të hapë një procedurë ankimi: identifikimin e verifikueshëm të ankueses dhe ekzistencën e legjitimitetit aktiv. Ankuesja nuk plotësoi kërkesën për verifikimin e identitetit nuk provoi se është viktimë e diskriminimit për një shkak të mbrojtur, nuk rezulton të veprojë në bazë të një autorizimi në emër të personave që pretendohet se janë diskriminuar si dhe nuk

ka statusin ligjor të një organizate me interesa legjitime, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, germa "b", të ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet për t'iu nënshtruar procedurave të mëtejshme për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, pika 4, germa "b", të ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, si dhe në nenet 3, pika 7, 33, 35, 37, 38, 44 dhe 65 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 177, datë 22.07.2026, paraqitur nga znj. A.M, për arsye se nuk përmbushen kushtet ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)